

Nr. .... Prot  
(Lutemi referoni këtë numër në përgjigje)

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2023

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik “JUNIK” sh.p.k, NIPT J68007522L, me adresë: Lagjja SMT, Ndërtesa dykatëshe, kati i dytë, pranë Drejtorisë Shërbimit Pyjor, Lezhë.

**Procedura e prokurimit/lotit:** Procedurë e Hapur – Punë – Mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik, ku të gjithë kushtet janë të përcaktuara.

**Numri i procedurës / referenca e Lotit:** NR-REF- 65259-04-06-2023.

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Riparimi i dëmtimeve të turbinave të AG1 dhe AG3 në HEC Fierzë dhe i dëmtimeve të turbinave të 5 (pesë) agregateve në Hec Vau Dejës”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 12 (dymbëdhjetë) muaj ose me mbarimin e vlerës së kontratës.

**Publikimet e mëparshme:** Buletini i Njoftimeve Publike Nr.32, datë 11/04/2023.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë ka marrë pjesë ofertuesi i mëposhtëm me vlerën përkatëse të ofruar:

**1-** Operatori Ekonomik “JUNIK” sh.p.k, NIPT J68007522L, me adresë: Lagjja SMT, Ndërtesa dykatëshe, kati i dytë, pranë Drejtorisë Shërbimit Pyjor, Lezhë, me ofertë ekonomike 43,462,140 (dyzetë e tre milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

#### Nuk ka.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “JUNIK” sh.p.k, NIPT J68007522L, me adresë: Lagjja SMT, Ndërtesa dykatëshe, kati i dytë, pranë Drejtorisë Shërbimit Pyjor, Lezhë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 43,462,140 (dyzetë e tre milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Përsa i përket afateve të ankimit, referuar nenit 96 pika 2 gërma (b) të Ligjit Nr. 162 datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku citohet se “Periodha e pritjes, e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohet në rastin e procedurave me një ofertues të vetëm, i cili është

kualifikuar dhe shpallur fitues”, për procedurën e sipërcituar, duke qenë se ka pasur vetëm një ofertues të kualifikuar dhe të shpallur fitues, nuk aplikohet periudha e pritjes.

Rrjedhimisht jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor KESH sh.a., sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Ergys Verdho**